

V E N D I M
Nr.416, datë 9.7.1998

**PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË MINISTRISË SË
EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT NGA PRIVATIZIMI I SHOQËRIVE
TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORË JOSTRATEGJIKË**

(Ndryshuar me vendimin nr. 253, datë 30.4.2004)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorë jostrategjikë”, me propozimin e *Ministrisë së Ekonomisë*, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Krijohet fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe të shoqërive tregtare shtetërore nga të ardhurat, prej 20 për qind, të përfituara nga shitja e paketës së aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë.

2. Ky fond administrohet dhe përdoret nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për:

a) zhvillimin e ndërmarrjeve që nuk janë transformuar në shoqëri tregtare shtetërore;

b) asistencë teknike për mbështetje pas transformimit në shoqëri tregtare shtetërore, për të ndihmuar në privatizimin e paketës së aksioneve të tyre;

c) promovimin e procesit të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare shtetërore;

ç) përgatitjen e dokumenteve për termat e referencave të tenderave, si formë e privatizimit të paketës së aksioneve të shoqërive tregtare shtetërore.

d. shpenzimet për shoqëritë anonime e ndërmarrjet shtetërore të shpallura në likuidim dhe atyre në proces privatizimi, që nuk kanë mundur të shiten.

Dhënia e këtyre fondeve të bëhet sipas preventivave përkatëse të shpenzimeve, të argumentuara nga ministrinë e linjës.

3. Kontrolli i administrimit dhe i përdorimit të këtij fondi të bëhet në përputhje me rregullat që zbatohen me fondet buxhetore, sipas ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Ky fond të përdoret brenda limitit të miratuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Ekonomisë, në titullin “Mbështetje për ndërmarrjet në likuidim”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë udhëzimin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano